

Data di pubblicazione: 2 dicembre 2023

ILIR PANDA*

*Aspekte juridike penale të korrupsionit në Republikën e
Shqipërisë***

KEYWORDS: *corruption; Constitution; public institutions*

SUMMARY: 1. Çfarë është korrupsioni. - 2. Çfarë parashikon legjislacioni për korrupsionin. - 3. Ligjet e posaçme për të luftuar korrupsionin.

1. Çfarë është korrupsioni

Korrupsioni! Të gjithë diskutojnë për të. Por çfarë është ai? Një veprim? Një mendësi? Një fenomen? Një gjë e dimë dhe biem dakord. Sigurisht që

* President i kolegjit penal te Gjykatës së lartë në Republikën e Shqipërisë.

** Ky është një relacion i mbajtur në konferencën ndërkombëtare me temën *Le misure di contrasto alla corruzione. Una prospettiva comparata e interdisciplinare*, e zhvilluar në datën 20 qershor 2023 pranë l'Universitetit Katolik Zoja e Këshillit të Mirë, Tiranë.

është negativ. Dhe të merresh me gjëra negative nuk është ndonjë kënaqësi e madhe. Mirëpo ndryshon puna kur të duhet të merresh për shkak të profesionit. Është pak a shumë si puna e mjekut, të cilit për ta shëruar sëmundjen i duhet të merret me të.

Mua më është bërë zakon që kur trajtoj një temë, të fokusohem te titulli dhe t'i drejtohem etimologjisë dhe origjinës së fjalës. Në fjalorin e gjuhës shqipe, folja korruptoj përkufizohet si një veprim i cili e prish dikë nga ana morale për qëllime të caktuara; e shtyn dikë me anë ryshfetesh, privilegjesh, etj. të shkelë ligjet ose të veprojë në kundërshtim me detyrën që ka, për të bërë shërbime ndaj dikujt. Zakonisht fjalorët, krahas shpjegimit të fjalëve, japin edhe një ose disa shembuj. Dhe shembujt që do të gjeni për përdorimin e foljes korruptoj janë korruptoi punonjësin, policin, mjekun, prokurorin, gjyqtarin, etj.

Kur trajton korrupsionin ndeshesh me dy lloj perceptimesh. Perceptimi publik dhe ai profesional juridik.

Nëse bëni një kërkim në Google në gjuhën angleze, me fjalët që, të përkthyer në shqip, do të ishin: Cili është rasti më i vjetër i dokumentuar i korrupsionit, do të mund të konstatooni korrupsionin në sistemin gjyqësor të Dinastisë së Parë në Egjiptin e Lashtë, e cila daton në vitet 3100-2700 Para Krishtit. Sigurisht që, duke menduar për kufizimet e gjuhës së shkruar asokohe, mund të aludohet se korrupsioni është edhe shumë më i hershëm, në mos i njëkohshëm me formimin mendor të njeriu. Pastaj perceptimet publike zgjerohen apo ngushtohen, sipas njerëzve që kanë

komentuar apo shkruar. Dhe fakti ka të bëjë, në përgjithësi, me veprimin jo korrekt apo jo të rregullt të njeriut.

Po të vijmë ca më afër kohës tonë (relativisht me afër), në poemat Homerike, do të gjejmë gjurmë të qasjes të cilat edhe dhuratat i trajtojnë si, prishje e moralit. Besoj se të gjithë e kemi të njohur Uliksin dhe kalin e famshëm të Trojës. Sigurisht që për këtë kryevepër të mitologjisë greke mund të flitet gjatë, por për hir të argumentit që po zhvillojmë mund të mbërrijmë lehtësisht në dy përfundime:

1. dhurata i hap të gjitha dyert;
2. dhuratën e pranon edhe mbreti.

Ndërsa trojanëve të mjerë “dhurata” u kushtoi ekzistencën. Historia e njerëzimit dhe e zhvillimit të shtetit ka dëshmuar praninë e vazhdueshme të korrupsionit në mbretëri, perandori, deri në shtete të botës demokratike, aty ku ekzistojnë edhe institucione të mirëfillta të luftës kundër korrupsionit. E parashtruar në këtë formë, duket sikur korrupsioni është në natyrën e njeriut ndaj nuk kemi ç'bëjmë! Në fakt, është krejt e kundërta! Fakti që një sjellje e tillë dëmtuese mund të jetë në natyrën e njeriut na jep përgjegjësinë e korrigjimit të saj për hir të bashkekzistencës në shoqëri. Dhe të gjitha studimet e bëra në këtë fushë shkojnë në një drejtim: « E vetmja mënyrë për të luftuar dhe parandaluar korrupsionin është të edukohemi lidhur me të»!

Sigurisht që përveç perceptimit publik ose me fjalë më të thjeshta popullor (ose e thënë me thjeshtë perceptimit popullor) ajo ku do të fokusohemi me gjere është koncepti juridik.

2. Çfarë parashikon legjislacioni për korrupsionin

Përpara se të shtjellojmë konceptin penal të korrupsionit si një nga veprat penale, le të trajtojmë shumë shkurt se ç'është vetë vepra penale. Sipas teorisë së të drejtës penale në Shqipëri, me vepër penale do të kuptojmë atë veprim ose mosveprim shoqërisht të rrezikshëm, të parashikuar nga ligji si të tillë dhe të dënueshëm prej tij. Veprat penale ndahen në krime dhe kundërvajtje. Këto të dytat janë vepra penale më të lehta të cilat dënohen maksimumi deri në dy vjet burgim. Ndërsa krimet janë veprat penale më të rënda. Dënimi maksimal me burgim për to në Shqipëri është deri në 35 vjet; ndërsa për kryerjen e një krimi të rëndë jepet edhe dënimi me burgim të përjetshëm.

Në shkencën juridike dispozitat ligjore ndahen në dispozita materiale dhe dispozita procedurale.

Dispozitat materiale penale parashikohen në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë dhe në ligje të tjera.

Dispozitat procedurale penale parashikohen në Kodin e Procedurës Penale dhe në ligje të tjera që përmbajnë norma procedurale. Po ashtu edhe në ligjet që parashikojnë organizimin dhe funksionimin e institucioneve dhe organeve të ndryshme të drejtësisë penale.

Ndërsa dispozitat më kryesore dhe të rëndësishme parashikohen që në Kushtetutë.

Por le të trajtojmë konkretisht korrupsionin.

Në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë ka rreth 20 nene të cilat, që në titull përmbajnë fjalën korrupsion. Në pamundësi për tu marrë me secilin prej tyre, do të ndalem tek elementet gruporë të asaj që në jurisprudencë quhet “figura e veprës penale”.

Kur pak më sipër, permenda se ka njerëz që edhe dhuratat i quajnë sjellje/veprime të pamoralshme e kisha me dyshim sepse, për shembull, edhe mua personalisht, meqenëse e kam personazhin më të dashur të mitologjisë, nuk më pëlqen që të ma njollosin figurën e Ulksit/Odiseut, qoftë edhe duke i vënë epitetin dinak. Në një kohë që në përkthimet mjeshtrërore që i janë bërë Homerit në gjuhën shqipe (nga Pashko Gjeçi dhe Llambro Ruci) Odiseu përshkruhet si një burrë ose i urtë ose mendjemprehtë. Mirëpo, nëqoftëse qasja/perceptimi i publikut shkon deri te dhuratat, çfarë gjejmë sot në legjislacionin penal dhe në jurisprudencë? Pothuajse në të gjitha nenet që bëjnë fjalë për korrupsionin, fjala, ose, më saktë, togfjalëshi është përfitim i parregullt, që ka të bëjë me mënyrën e kryerjes së veprimeve. Pra nuk është se ka ndonjë ndryshim të madh edhe me kalimin e shekujve! Ndërsa ndryshimet ndërmjet neneve/dispozitave qëndrojnë si më poshtë:

Në cilin sektor kryhet? Në sektorin publik apo privat?

Cili është subjekti që e kryen? Është shtetas apo është punonjës shtetëror ose në shërbim publik? Është funksionar shqiptar apo i huaj?

Çfarë veprim bën? Në kuptimin që «premtan; propozon; jep; merr; pranon; kërkon».

Sepse korrupsioni përfshin gjithmonë dy palë: Atë që jep dhe atë që merr. Por mund të jetë edhe e kundërta: ai që kërkon dhe ai që pranon të japë. Në titujt dhe nenet përkatëse të Kodit Penal shqiptar veprimi korruptiv ndahet në dy lloje; në aktiv dhe në pasiv. Ndërsa teksti i nenit sqaron se prej kujt dhe si kryhet veprimi shoqërisht i rrezikshëm dhe i dënueshëm sipas Kodit.

Në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin Nr. 7895, datë 27.1.1995, ndarja është bërë në krerë të ndryshëm, si, për shembull:

Në Kreun III, janë të parashikuara «Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike», të cilat kryhen nga ose ndaj personit që ushtron funksion drejtues në shoqëri tregtare ose punon në çdo pozicion në sektorin privat.

Në Kreun VIII, të titulluar «Krime kundër autoritetit të shtetit», gjejmë të parashikuara në Seksionin I, «Vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit». Ndërsa në Seksionin II, gjejmë «Vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik».

Kodi Penal parashikon edhe «Vepra penale kundër drejtësisë», në Kreun IX të tij. Në këtë kre, krahas veprave të ndryshme penale, janë të parashikuara edhe veprimet të cilat janë konsideruar si korrupsion, duke filluar që nga korruptimi i dëshmitarit, ekspertit apo përkthyesit dhe deri te korruptimi i magjistratëve (prokurorit ose gjyqtarit), ndihmësmagjistratëve apo i funksionareve të tjerë të drejtësisë dhe atyre që mund të kenë statusin e nëpunësit publik gjyqësor ose të punonjësit të

gjykatës. Përveç funksionareve apo punonjësve vendas Kodi penal parashikon se korrupsioni ushtrohet edhe kundrejt ose nga gjyqtarë, zyrtarë të një gjykate të huaj, gjykate ndërkombëtare, jurie gjyqësore të huaj ose arbitra.

Një vend të posaçëm zënë edhe «Veprat penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve», të parashikuara në Kreun X. Meqenëse në periudhat para dhe pas zgjedhjeve, në Shqipëri ka patur probleme lidhur me to; me legjitimitimin e tyre, ligjvënësi shqiptar ka parashikuar dhe, në vitet e fundit, ka shtuar dhe ndryshuar vazhdimisht dispozitat lidhur me korrupsionin në procesin zgjedhor që bëhet nga kandidatet ose persona të tjerë, duke i specifikuar veprimet; si, për shembull: ofrim; dhënie; premtim; angazhim; mbështetje; kërkim; pranim; favorizim, etj. Por, për çfarë? Për dhënie të hollash, premtim për vend pune, favorizime të tjera për marrjen e firmës për paraqitjen e një kandidati për zgjedhje, për të votuar në një mënyrë të caktuar, për të marre pjesë ose jo në votime, për tu angazhuar në veprimtari të paligjshme, për mbështetjen e një kandidati ose një partie politike. Në Kodin Penal janë nenet 328 dhe 328/b që parashikojnë korrupsionin në zgjedhje.

Duhet patur kujdes që veprat penale të korrupsionit të mos ngatërrohen me vepra të tjera penale të ngjashme me të, pra që kanë elemente të ngjashme, por jo të njëjta. Vepra të tjera të ngjashme mund të jenë:

Shpërdorimi i detyrës, në nenin 248.

Vjedhja duke shpërdoruar detyrën, në nenin 135.

Marrja e shpërblimeve, në nenin 217, të Kreut V - Krime kundër pavarësisë dhe rendit kushtetues, Seksioni I - Krime kundër pavarësisë dhe integritetit.

Kërkimi ose marrja e shpërblimeve për procedurat e birësimit, në nenin 124/a, Seksioni IX - Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes. Përmendëm më sipër se dispozitat kryesore parashikohen në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Në Pjesën e Nëntë, të titulluar Gjykatat, në nenin 135 të Kushtetutës, gjejmë të parashikuar se:

1. Pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, si dhe nga gjykatat e apelit e gjykatat e shkallës së parë, të cilat krijohen me ligj.
2. Gjykatat e posaçme gjykojnë veprat penale të korrupsionit dhe të krimit të organizuar, si dhe akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Kryetarit të Bashkisë, deputetit, zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj, si dhe akuzat kundër ish-funksionarëve të sipërpërmendur.

Por, përpara se të gjykohen, veprat penale duhet të hetohen dhe sipas nenit 148/dh të Kushtetutës, është Prokuroria e Posaçme e cila ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën para gjykatave të posaçme dhe para Gjykatës së Lartë.

Kodi i procedurës penale i Republikës së Shqipërisë, miratuar me Ligjin Nr.7905, datë 21.3.1995, në zbatim të Kushtetutës, i detajon kompetencat dhe procedurat që ndjekin gjykata dhe prokuroria e posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Gjykata dhe prokuroria kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar u krijuan me ndryshimet kushtetuese të vitit 2016, në kuadrin e reformës në drejtësi, mbi shtratin institucional dhe profesional të gjykatës dhe prokurorisë për krime të rënda, të cilat kishin filluar funksionimin në vitin 2004.

3. Ligjet e posaçme për të luftuar korrupsionin

Ndër ligjet e posaçme që trajtojnë luftën ndaj korrupsionit është edhe Ligji Nr. 95/2016, «Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar».

Qëllimet paresore të këtij ligji janë:

1. Garantimi i funksionimit të Prokurorisë së Posaçme, si një prokurori e specializuar, për të ushtruar kompetencat e parashikuara në pikën 1, të nenit 148/dh, të Kushtetutës, në mënyrë efikase dhe të pavarur nga çdo ndikim i paligjshëm, i brendshëm apo i jashtëm.
2. Garantimi i funksionimit të Njesisë së Pavarur Hetimore për të hetuar veprat penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar, si dhe veprat e tjera penale të kryera vetëm nga subjektet e parashikuara në pikën 2, të nenit

135, të Kushtetutës, të pavarur nga çdo ndikim i paligjshëm, i brendshëm apo i jashtëm.

Me siguri që ju keni dëgjuar të flitet për SPAK-un; një emër disi interesant apo edhe paksa “trendy”. Çfarë është ai e gjejmë në përkufizimet e termave, në nenin 3, pika 7, të ligjit, sipas të cilit, «Struktura e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar» përdoret për t’iu referuar Prokurorisë së Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe Njësisë së Posaçme Hetimore, e cila emërtohet «Byroja Kombëtare e Hetimit». Struktura e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar (SPAK). Pra, formalisht, është një akronim i togfjalëshit «Struktura e Posaçme Antikorrupsion».

Sipas nenit 5 të ligjit, Byroja Kombëtare e Hetimit është strukturë e specializuar e Policisë Gjyqësore, që heton veprat penale në juridiksionin penal të Prokurorisë së Posaçme, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale. Ajo ka në përbërje të saj hetuesit dhe Shërbimet e Policisë Gjyqësore sipas këtij ligji.

Prokuroria e Posaçme, ndër të tjera, ka edhe disa sektorë të rëndësishëm, si: Sektori i Dokumentacionit, Sektori i Ekspertizës, Sektori i Hetimit Financiar, Sektori për Bashkëpunimin Ndërkombëtar dhe Hetimet e Përbashkëta, Koordinatorin për Marrëdhëniet me Mediat dhe Sektori për Asistencën për Individët me Status të Posaçëm.

Nje nga mengjeset e zakonshme, ndërsa pija kafën në lokalin poshtë shtëpisë, në tavolinën ngjitur me mua disa fëmijë luanin duke u hequr se ishin me pushime diku në Greqi. Më tërhoqi vëmendjen dhe më pëlqeu

teksa i dëgjoja të imitonin të rriturit, të flisnin tek-tuk ndonjë fjalë greqisht dhe iu gëzova aftësisë së tyre për të mësuar me shpejtësi. Mirëpo gëzimi nuk më zgjati shumë. Njëra nga vajzat, ajo që luante rolin e recepcionistes, i tha çiftit (dy fëmijë që rrinin seriozë dhe trokisnin gishtat mbi tavolinë) se dhoma e tyre nuk kishte sauna pasi një familje tjetër kishte prenotuar të vetmen dhomë me sauna në hotelin e tyre. Ne atë moment, djali bëri sikur futi dhe nxori dorën nga xhepi dhe e mbylli grusht, si të kishte lekë brenda tij. Pastaj e futi grushtin poshtë kartëpecetës që gjendej mbi tavolinë dhe i tha vajzës që luante rolin e recepcionistes: «Shiko edhe një herë se mos është e lirë ajo dhoma me sauna». Në atë moment mendova se do doja që fëmijët të mos imitonin!

Në vijim, fillova të kërkoj përgjigjen e pyetjeve: «Pse korruptohet njeriu»? Pse korruptohen njerëzit parimorë dhe të moralshëm? Si ka mundësi që mund të korruptohen fëmijët? A ka një “vaksinë” kundër korrupsionit? Përgjigjet që me erdhen ne mendje ishin këto: Njerëzit korruptohen prej grykësisë për lekë dhe për të plotësuar çdo dëshirë, të ndihmuar nga monopolizimi i tregut dhe politikës, nivelet e ulëta të demokracisë, pjesëmarrjes së dobët qytetare dhe mungesës së transparencës politike. Njerëzit parimorë dhe të moralshëm korruptohen si pasojë e konformizmit, bindjes ndaj autoritetit dhe nevojës për të qenë pjesë e një grupi. Fëmijët korruptohen sepse imitojmë modelet e prindërve dhe të të rriturve të tjerë. Lajmi i mirë është që korrupsioni mund të ndalet. Lajmi më i mirë akoma është që mënyra për ta ndalur korrupsionin është përmes edukimit.

Referencat bibliografike

Dispozitat materiale penale, Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin Nr. 7895, datë 27.1.1995.

Dispozitat procedurale penale, Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë.

Garantimi i funksionimit të Njësisë së Pavarur Hetimore, pika 2, neni 135, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Garantimi i funksionimit të Prokurorisë së Posaçme, pika 1, neni 148/dh, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë

Kërkimi ose marrja e shpërblimeve për procedurat e birësimit, neni 124/a, Seksioni IX - Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes.

Korrupsioni në zgjedhje, nenet 328 dhe 328/b, Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.

Krime kundër autoritetit të shtetit, Kreu VIII, Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.

Vepra penale kundër drejtësisë, Kreun IX, Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.

Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike, Kreu III, Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.

Veprat penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, Kreun X, Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.